

INFORMATA MBI TATIMET

TATIMET E BIZNESEVE:

Tatimpaguesit deri në 50.000 Euro të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste kanë për obligim të paguajnë:

3% të të ardhurave bruto nga tregtia, transporti apo bujqësia për çdo tremujor (minimum 37.50€ në tremujor).

9% të të ardhurave bruto nga shërbimet, veprimtaritë profesionale të zanatit, argëtimit dhe të ngjashme për çdo tremujor (minimum 37.50€ në tremujor).

Tatimpaguesit me mbi 50.000 Euro të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste dhe ata që përzgjedhin të paguajnë në bazë të fitimit, paguajnë 10% të fitimit të tatueshëm për Tatim në të Ardhura në Korporata.

TATIMET E PAGAVE:

Tatimpaguesit e Tatimit në të Ardhura Personale paguajnë në bazë të shkallëve tatimore:

Paga vjetore e tatueshme:

Paga vjetore e tatueshme	Norma e tatimit e shprehur ne %
0 deri 960	0%
960 deri 3000	4%
3000 deri 5400	8%
mbi 5400	10%

Paga mujore e tatueshme:

Paga mujore e tatueshme	Norma e tatimit e shprehur ne %
0 deri 80	0%
80 deri 250	4%
250 deri 450	8%
mbi 450	10%

Tatimpaguesi i cili nuk është punëdhënës kryesor dhe do të paguajë page dytësore për të punësuarin e tij, do të mbaj në burim tatimin në shkallën maksimum **10%**

TATIMET NGA QIRAJA:

Në bazë të ligjit mbi Tatimin në të Ardhura Personale, nga qiraja bruto do të zbriten **10%** në emër të shpenzimeve të lejueshme dhe pastaj në neto qira do të aplikohet norma prej **10%**. Rezultat i kësaj do të jetë pagesa e qerasë në shkallën **9%** nga qiraja bruto për çdo tremujor.

Shembull:

- Qiraja Bruto Mujore = 1.000 Euro x 3 muaj = 3.000 Euro në tremujor
3.000-10% shpenzime të lejuara = 2.700 x 10% norma e tatimit = 270 [Tatimi ne qira];

Kjo është e njëjtë sikur nga qiraja bruto 3.000 Euro të aplikojmë normën 9%, rezultati do të jetë 270 Euro tatimi në qira për pagesë.

AFATI I DEKLARIMIT TË TATIMIT NË FITIM PËR BIZNESE

Tatimpaguesit të cilët duhet të përgatitin Deklaratën Tatimore vjetore, e të cilën duhet ta dorëzojnë deri me **1 Prill të vitit pasues**, në fitimin e tyre të tatueshëm që është rezultat i asaj deklarate, do të aplikojnë normën tatimore 10%;

TATIMI I FITIMIT NË BIZNESE

Tatimpaguesit të cilët zgjedhin që të paguajnë këstet e tyre tremujore për një vit në bazë të parashikimit, pagesa e kësteve do të bëhet duke aplikuar shkallën 10% në fitimin e paraparë.

- Fitimi i paraparë do të jetë rezultat i ndryshimit në mes të ardhurave të parapara për periudhën tatimore pjesëtuar me 4 dhe shpenzimeve të parapara për Periudhën Tatimore pjesëtuar me 4.

Shembull:

- Detyrimi tatimor i vitit 2014 i cili do të jetë rezultat i deklarates vjetore të tatimit në të ardhura të bizneseve është = 10.000 €
- 10.000/2 = 5.000Euro do të jetë baza përlogaritëse për pagesën e kësteve të vitit 2015
- 5.000 x 110% = 5.500
- 5.500 / 4 = 1375 është pagesa që do të bëhet me secilin këst për vitin 2015.

